



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGJISË  
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK  
PER MINIERAT DHE INDUSTRIE  
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 2083.....

Tirane, date 23.2./2015

**Drejtuar:** Z. Luan Saliaj, Administrator  
Shoqëria "Albchrome" Shpk  
Pall. Classic Construction, Kati 2, Rruga Budi, ZK8160

TIRANE

**Lënda:** Njoftim mbi fillimin e procedurave për ndryshimin e koordinatave të lejes minerare nr.677/2, datë 16.09.2002.

**I nderuar** Z. Saliaj,

Shoqëria "Albchrome" shpk është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.677/2, date 16.09.2002, për shfrytëzimin e mineralit të kromit në objektin Bulqize, Qarkun Dibër.

Në zbatim të nenit 47, pika a1, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me kërkesë të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), struktura përgjegjëse, AKBN me shkresën nr.2200/1, date 16.02.2014 ka dërguar dokumentacionin e verifikimeve te mbivendosjeve te lejeve minerare në zonën e Bulqizës, si dhe ka propozuar ndryshimet qe duhen bere në koordinatat e lejes tuaj nr.677/2, datë 16.09.2002, për të shmangur mbivendosjen me lejen minerare nr.1271/2, datë 15.05.2012 dhe lejen minerare nr.1569, datë 26.06.2012.

Koordinatat dhe sipërfaqja e zonës minerare e cilat do të hiqet nga sipërfaqja e miratuar e lejes minerare nr.677/2, datë 16.09.2002, është si me poshtë:

Koordinatat e zonës minerare (I) e cila  
do të hiqet nga sipërfaqja e lejes  
minerare nr.677/2

Nr	Koordinatat	
	Y	X
1	44 34 916	45 94 070
2	44 34 914	45 94 108
3	44 35 180	45 94 164
4	44 35 203	45 95 104

Koordinatat e zonës minerare (II) e cila  
do të hiqet nga sipërfaqja e lejes  
minerare nr.677/2

Nr	Koordinatat	
	Y	X
1	44 35 038	45 94 206
2	44 35 038	45 94 300
3	44 35 106	45 94 220

Sa me sipër, në zbatim të nenit 47, pika a1, të ligjit nr.10304, datë 22.06.2012, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ju njoftojmë se ka filluar procedura e ndryshimit të koordinatave të lejes minerare nr.677/2, datë 16.09.2002, për të shmangur mbivendosjen si me sipër.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim do të merret vendimi për ndryshimin e koordinatave të lejes minerare si me sipër.

**Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.**

**MINISTRI**

**DAMIAN G.JIKNURI**

